

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEÇE KAI**

GSK-KPA-A-41/15

**Prishtinë,
7 dhjetor 2017**

Në çështjen juridike të:

H.H.

I përfaqësuar nga
Avokati N. K.

Pala ankuese

kundër

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit
Prishtinë**

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/232/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00443), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 7 dhjetor 2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N. K. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/232/2014, të datës 13 mars 2014.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/232/2014, i datës 13 mars 2014 për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencionin Kosovar të Pronës me numrin KPA00443.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 23 nëntor 2006, H. H. (në tekstin e mëtejme “pala ankuese”) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme “AKP”) në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore (në tekstin e mëtejme “BDP”), ku kërkonte ririposimin e pronës komerciale që ndodhet në ngastrën kadastrale nr. 1498/7 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4588 m², në Fushe Kosovë (në tekstin e mëtejme “prona e kërkuar”). Pala ankuese ka deklaruar se humbja e posedimit kishte ndodhur më 1 qershor 1999. Sipas H.H., titulli i tij pronësor ishte vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Prishtinës të lëshuar në lëndën P. br. 1893/05.
2. Së bashku me kërkesën e tij pala ankuese kishte dorëzuar në AKP *inter alia*:
 - Kopjen e Kontratës së Shitblerjes së Pronës së Paluajtshme të lidhur në Beograd më 7 dhjetor 2004 në mes të shoqërisë aksionare “Izolacija Holding” Beograd si shitës dhe palës ankuese si blerës të “pjesës lindore të hapësirës magazinuese në Zonën Industriale në Prishtinë me sipërfaqe të përgjithshme prej 700 m², e cila paraqet një pjesë të hapësirës magazinues në formë të shkronjës “L”, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1300 m², që ndodhet në ngastrën kadastrale nr. 1498/7”. Nënshkrimet poshtë kontratës ishin vërtetuar nga nëpunësi i Gjykatës Komonale në Beograd.
 - Kopjen e Aktgjykimit të lëshuar në lëndën P.br. 1893/05 nga Gjykata Komonale në Prishtinë më 27 dhjetor 2005 e cila njihje të drejtat pronësore të palës ankuese mbi – *inter alia* – ajo ka kërkuar kë pronën.
 - Kopjen e Fletës Poseduese nr. 8961 të lëshuar më 22 korrik 1996 që e paraqet pronën e kërkuar të ishte nën pronësi të ndërmarrjes shoqërore “Izolacija”.
 - Kopjen e Autorizimit (në tekstin e mëtejme “autorizimi”) të lëshuar më 19 shkurt 2007, sipas të cilit pala ankuese e kishte autorizuar avokatin N. K. “që të ndërmerre në emër të tij të gjitha veprimet e tjera ligjore lidhur me pronën e paluajtshme të përshkruar në dispozitiv të Aktgjykimit të marrë në lëndën P. br. 1893/05 pranë të gjitha organeve dhe institucioneve kompetente në Kosovë”. Nënshkrimi i palës ankuese ishte vërtetuar nga nëpunësi i Gjykatës Komonale në Rozhajë.
3. Lënda ishte regjistruar me numrin KPA0000443.
4. Më 15 korrik 2008 kërkesa ishte dorëzuar te autoritetet e “Arberia” Company, por ato kishin refuzuar të nënshkruanin Njoftimin për pjesëmarrje dhe që të jepnin ndonjë koment në lidhje me pronën e kërkuar.

5. Më 21 qershor 2010, njoftimi mbi kërkesën që ishte në proces ishte publikuar në Gazetën Njoftuese të AKP-së nr. 2, në Komunën e Fushë Kosovës dhe Zyrën Kadastrale të së njëjtës, Gjykatën Komunale të Prishtinës, Zyrën Regjionale të AKP-së në Prishtinë. Për më tepër, Gazeta dhe Lista ishin shpërndarë në Zyrën Qendrore të UNHCR-it, Ombudsperson, Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe në Zyrën e UNMIK-ut në Graçanicë.
6. Njoftimi lidhur me kërkesën ishte bërë edhe për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme "AKP") më 11 nëntor 2013. Më 13 dhjetor 2013, AKP-ja duke vepruar në emër të ndërmarrjes shoqërore "Izolacija" nga Beogradi kishte paraqitur përgjigje në kërkesë ku kishte kërkuar që të hidhet poshtë që subjekti i saj t'i referohet pronës shoqërore që ceket në emër të NSH "Izolimi" me seli në Beograd, apo që të refuzoj atë si të pabazuar. AKP-ja kishte argumentuar se procedura e ndjekur nga pala ankuese e cila siç pretendohet e kishte qar atë në fitimin e të drejtave pronësore mbi pronën e kërkuar ishte në shkelje të disa ligjeve: Nenit 36 të Ligjit nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore dhe Nenit 9 të Ligjit për Qarkullimin e Patundshmërive, Nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore. Gjithashtu, AKP-ja kishte nënvijëzuar se Kontrata e përmendur nga pala ankuese mbetet pa efekt juridik pasi që ajo nuk është vërtetuar nga gjykata brenda territor të së cilës ndodhet prona e paluajtshme. Gjithashtu, sipas AKP-së, Aktgjykimi i datës 27 dhjetor 2005 i dorëzuar nga pala ankuese ishte lëshuar nga gjykata jo-kompetente. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme "DHPGJS") megjithatë më 30 qershor 2009 e kishte tërhequr lëndën nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Rrjedhimisht, AKP-ja sqaroi se, pala ankuese më 26 gusht 2013 ka paraqitur kërkesë në DHPGJS për vërtetimin e të drejtave pronësore ndaj ngastrës kadastrale nr. 1498/7, duke kërkuar kthimin e saj në posedimin e tij.
7. Më 13 mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme "KKPK"), me Vendimin e vet KPCC/D/C/232/2014 (në tekstin e mëtejme "Vendimi i KKPK-së") e kishte hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetim të vendimit të saj (paragrafi 312), KKPK-ja theksonte se pala ankuese nuk e kishte dëshmuar se kërkesa e tij përfshinte rrethanat që drejtpërdrejtë kishin të bënin me konfliktin e viteve 1998-99 apo rezultinin nga ai konflikt. Prandaj ajo kërkesë kishte rënë jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe duhej hedhur poshtë.
8. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 12 gusht 2014 ndërsa palës përgjegjëse në ankesë më 11 korrik 2014. Më 8 shtator 2014 pala ankuese kishte paraqitur ankesë kundër Vendimit të KKPK-së. Më 4 shkurt 2015 ankesa i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë, ndonëse ajo nuk ishte përgjigjur në të.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore të ligjit të zbatueshëm; dhe mbështet mbi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës të miratoj ankesën, ta prish Vendimin dhe të kthej lëndën në rigjykim. Sipas palës ankuese, Komisioni nuk e ka sqaruar se cilat dokumente e kishin qar atë në konstatimin e shprehur në Vendim.

Arsyetimi ligjor

10. Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së ishte lëshuar pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi një bazë të tillë edhe e drejta materiale dhe ajo procedurale ishin aplikuar drejt. Prandaj, ankesa është refuzuar si e pabazuar.
11. KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën duke konsideruar se pala ankuese nuk e kishte provuar se kërkesa e tij përfshinte rrethanat që drejtpërdrejtë kishin të bënim me konfliktin e viteve 1998-99 apo rezultonin nga ai konflikt. Në të vërtetë, dosja e lëndës nuk e përmban asnjë dokument që e dëshmon titullin e palës ankuese mbi pronën e kërkuar para apo gjatë konfliktit në fjalë dhe se humbja e posedimit ndaj saj kishte ndodhur gjatë asaj periudhe. Përkundrazi, pala ankuese e kishte arsyetuar kërkesën duke sqaruar se ai i kishte fituar të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar mbi bazën e Kontratës së Shitblerjes të lidhur më 7 dhjetor 2004, vlefshmëria e së cilës më pas ishte verifikuar dhe vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës të lëshuar më 27 dhjetor 2005. AKP-ja duke vepruar në emër të NSH “Izolimi” nga Beogradi kishte kontestuar jo vetëm vlefshmërinë e Kontratës së përmendur, por edhe kompetencën e gjykatës për të lëshuar aktgjykim në lidhje me tokën nën pronësi shoqërore, duke theksuar me këtë rast se aktgjykimi nuk është i plotfuqishëm dhe lënda është ende në pritje të zgjidhjes pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.
12. Është me rëndësi të theksohet këtu se kontesti në mes të palëve ka të bëjë me çështjen e vlerësimit të efekteve juridike të Kontratës së lidhur më 7 dhjetor 2004. Burimi i kontestit në mes të palëve ishte shfaqur pas konfliktit që kishte ndodhur në Kosovë in 1998 dhe 1999. Ky fakt i vetëm tashmë e përjashton juridiksionin e KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së për të trajtuar kërkesën.
13. Roli i AKP-së megjithatë nuk është për të zëvendësuar gjykatat në Kosovë për të gjykuar lëndët që i përkasin kompetencës së tyre. Pala ankuese dhe pala përgjegjëse në ankesë megjithatë është dashur të adresojnë kërkesat e tyre në gjykatën e juridiksionit përkatës, që në këtë rast është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me AKP-në, që gjykon ankesat lidhur me pronat e paluajtshme shoqërore. Pala përgjegjëse në ankesë ka argumentuar se lënda ishte në pritje të zgjedhjes pranë kësaj së fundit.
14. Gjithashtu në rastin në fjalë, pala ankuese kishte paraqitur kërkesë në Gjykatën Komunale të Prishtinës që në vitin 2004. Gjykata Supreme konstaton megjithatë se sipas nenit 18 të Ligjit nr. 03/L-079: *“Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen ndaj çdo kërkesë nën nenin 3.1 të Rregullores në fjalë e cila është dorëzuar pranë gjykatës së juridiksionit kompetent, nëse procedurat gjyqësore për sa i përket kërkesës së tillë nuk kanë filluar para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores në cekur”*. Pra, dispozita e nenit të cituar duhet të kuptohet se juridiksioni i AKP-së përjashtohet nëse pala ka paraqitur kërkesë në gjykatën kompetente para datës 16 tetor 2010 (data e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50). Dokumentet që gjenden në dosjen e lëndës vërtetojnë rrethanën se pala ankuese ka kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore ndaj pronës së kërkuar. Prandaj, lënda në fjalë bie jashtë juridiksionit të AKP-së dhe për të njëjtën arsye edhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së.
15. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafi 1(d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Erdogan Haxhibeqiri , Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Ushtues Detyre i Referentit të EULEX-it